




Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr. 38/23  
Prishtinë më: 14.04.2023

Duke u bazuar në nenet 11,13,15,16,17,18,35,51 dhe 55 paragrafi 1.5 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 14.04.2023, mori këtë:

## V E N D I M

**I. LEJOHET**, Përqendrimi i ndërmarrjeve Sava Re d.d, për blerjen e 100% të aksioneve të Application Software Partner d.o.o, nga Zvonko Milosavljević dhe Biljana Pavlović Grahovac.

**Sava Re d.d**, është shoqëri aksionare, më numër të regjistrimit të biznesit: 5063825000, dhe numër identifikues të TVSH SI 17986141, me seli në 56 Dunajska cesta Lubjanë Slloveni. Me aktivitet të biznesit risigurimi, jetë dhe jo- jetë. Në territorin e Kosovës Sava Re d.d, ka në pronësi Shoqëritë e Sigurimeve Illyria Sh.A., dhe Illyria Life Sh.A.

**Kompania e sigurimeve Illyria Sh.A.** është shoqëri aksionare me numër unik identifikues 810483769 dhe numër të regjistrimit të biznesit 70152892, me adresë të regjistruar në Sheshin Nëna Terezë Nr.33,10000 Prishtinë, me aktivitete të biznesit sigurimin jo-jetë.

**Kompania për Sigurimin e Jetës Illyria – Life Sh.A.**, shoqëri aksionare me numër unik identifikues 810733837 dhe numër të regjistrimit të biznesit 70520893, me adresë të regjistruar në Sheshin, Nëna Terezë Nr. 33, 10000 Prishtinë, me aktivitete të biznesit sigurimi jetë.

**Application Software Partner d.o.o.** me seli të regjistruar në Bulevard, Kralja Aleksandra 17, me numër të regjistruar të biznesit: 17077295, TIN: 100050691 në Beograd, Republika e Serbisë. Aktiviteti i kompanisë: shërbime softuerike IT.

**Zvonko Milosavljević**, me vendbanim në 44 Gandijeva, Beograd-Nov, Beograd, numër të regjistrimit të biznesit ID:0910949710412 .

**Biljana Pavlović Grahovac**, me vendbanim 65 Dr, Ivana Ribara, Beograd-Novoi, Beograd, ID numër të regjistrimit të biznesit, 2804953715332, shitësit janë aksionarë të kompanisë Application Software Partner me 50% - 50% të aksioneve në biznes.

**II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim** obligohet të paguajë taksën administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind Euro) dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja (tre mijë Euro).

### **A r s y e t i m**

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 23.02.2023, me Nr. Prot. 74/23-01//H ka pranuar kërkesën për njoftim të Përqendrimit, përmes Z, Besim Parduzi, Përfaqësues Ligjor nga Sava Re d.d, lidhur me shitblerje të aksioneve në mes të Sava Re d.d. (blerësi) dhe Zvonko Milosavljević, dhe Biljana Pavlović Grahovac, (shitësit), për fitimin e kontrollit mbi Application Software Partner d.o.o. (targeti).

### **Procedurat e ndjekura:**

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 14.03.2023
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në ueb faqen e AKRK-së me dt. 13.03.2023
4. Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në Marrëveshjen për shitblerje të Aksioneve e lidhur me datën 08.02.202, ndërmjet Zvonko Milosavljević dhe Biljana Pavlović Grahovac, dhe Sava Re d.d mbi Application Software Partner d.o.o.,

### **Baza juridike:**

Sipas neni 13, të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000.00 Euro.
- b) Qarkullimi i një pale në tregun e brendshëm e kalon shumën 1,000,000.00 Euro
- c) Sava Re d.d do të blejë aksionet e Application Software Partner d.o.o, nga Zvonko Milosavljević, dhe Biljana Pavlović.
- d) Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve, datë: 08.02.2023
- e) Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye se blerësi është prezent në territorin e Republikës së Kosovës përmes kompanive të sigurimeve: Illyria SH. A dhe Illyria Life SH.A.

### **Vlerësimi i Konkurrencës**

**Tregu Relevant:** Struktura e kompanisë Sava Re d.d, nuk do të ndryshoj në tregun e Republikës së Kosovës.

**Tregu i produktit** - ka të bëjë më ofrimin e shërbimeve të softuerike, të IT-së.

**Tregu gjeografik** - përkitazi me tregun e sigurimeve, si treg përkatës gjeografik është definuar tregu i Republikës së Kosovës.

### **Tregjet e Prekura:**

Transaksioni nuk krijon tregje të prekura, pasi që pjesëmarrësit në përqendrim nuk operojnë në treg të njëjtë të produkteve dhe në tregun e njëjtë përkatës gjeografik, që do të thotë se mes tyre nuk ka mbivendosje horizontale e as vertikale, shitësi nuk është aktiv në Kosovë, pra nuk ka një filiale të regjistruar në Republikën e Kosovës dhe nuk është prezent as përmes shitjes, ndërsa pala blerëse është prezent në Kosovë përmes kompanisë Illyria Sh.A. dhe Illyria-Life Sh.A., megjithatë, këto kompani do ta ruajnë pozicionin aktual në tregun përkatës të Republikës së Kosovës.

### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar**

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Sllovenisë, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se pala blerëse është prezentë në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk mund të ketë efekt negativ në Kosovë dhe si e tillë nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg.

Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar se, këto transaksione nuk paraqesin efekte negative në konkurrencë për arsye se ky transaksion/blerje nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomikë apo konsumatorët.

**Shënim:**

Çdo formë e shtrebbërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij Vendimi dhe hyn në fuqi menjëherë, pas nënshkrimit nga Komisioni.

**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
Komisioni

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare



Kaltrina Sela  
Nënkryetare



Nafije Osdautaj  
Anëtare

